

**Ligji Nr. 05/L -036**

**PËR KOMPENSIMIN E VIKTIMAVE TË KRIMIT**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR KOMPENSIMIN E VIKTIMAVE TË KRIMIT**

**KREU I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij ligji është krijimi dhe funksionalizimi i programit për kompensim të viktimave të krimit.
2. Ky ligj është në pajtueshmëri me Direktivën e Këshillit 2004/80/EC të 29 prillit 2004 lidhur me kompensimin e viktimave të krimit.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Ky ligj rregullon të drejtën e kompensimit financiar të viktimave të veprave të dhunshme penale dhe të vartësve të tyre, autoritetet vendimmarrëse si dhe procedurat për realizimin e të drejtës për kompensim në situatat vendore dhe ndërkufitare.

**Neni 3  
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Viktimë e krimit** - nënkupton viktimën siç definohet me Kodin e Procedurës Penale. Për qëllim të kompensimit ky term përfshin gjithashtu, në raste të caktuara, anëtarin e familjes apo vartësit e viktimës direkt;

1.2. **Vartësit** - nënkupton personat e mbajtur nga i vdekuri dhe personat të cilët kanë pasur të drejtë me ligj që të kërkojnë të mbahen nga i vdekuri;

1.3. **Anëtar i familjes** - ka të njëjtin kuptim si në Kodin Penal të Republikës së Kosovës;

1.4. **Vepër e dhunshme e kompensueshme** - për qëllim të këtij ligji nënkupton një vepër të dhunshme, të përcaktuar me këtë ligj si e kompensueshme, dhe e cila rezulton në vdekjen e viktimës, lëndim të rëndë trupor apo dëmtim të rëndë të shëndetit fizik apo mendor;

1.5. **Fëmijë** - ka të njëjtin kuptim si në Kodin Penal të Republikës së Kosovës;

1.6. **Dëmi** - nënkupton dëmi që drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë rezulton nga një veprim kriminal, duke përfshirë humbjen e pronës, humbjen e fitimit, heqjen e lirisë, dëmtimin fizik, dëmtimin psikik apo humbjen e jetës së bashkëshortit ose anëtarit të familjes së afërme;

1.7. **Shpërfytyrim** - kur viktimë si pasojë e veprës është deformuar apo shëmtuar;

1.8. **Parashtruesi i kërkesës** - nënkupton personin i cili parashtron një kërkesë për kompensim me pretendimin se është viktimë e krimit. Ky term përfshin edhe personat tjerë të cilët mund të parashtrojnë kërkesë në emër të viktimës;

1.9. **Përfituesi** - nënkupton personin i cili me vendim të komisionit përfiton nga e drejta për kompensim sipas këtij ligji;

1.10. **Komisioni** - nënkupton komisionin për kompensimin e viktimave të krimit;

1.11. **Viktima e trafikimit** - ka të njëjtin kuptim si në Kodin Penal të Republikës së Kosovës;

1.12. **Viktima e ndjeshme** - ka të njëjtin kuptim si në Kodin Penal të Republikës së Kosovës;

1.13. **Reciprociteti** - me një shtet tjetër nënkupton që qytetarët e Republikës së Kosovës kanë qasje të barabartë në kompensim nën sistemin e kompensimit të viktimës në atë shtet;

1.14. **Territor i Republikës së Kosovës** - ka të njëjtin kuptim si në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

#### Neni 4

#### Parimet e përgjithshme

1. Autoritetet e parapara me ligj duhet të sigurohen që viktimat e krimit (në tekstin e mëtejshëm: Viktimat) të trajtohen me profesionalizëm, duke respektuar të drejtën në siguri, dinjitet, jetën private dhe familjare të tyre dhe duke njohur ndikimin negativ të krimit në viktimat e krimit.

2. Të drejtat e caktuara sipas këtij ligji duhet të vlejnjë për viktimat në mënyrë jo-diskriminuese duke përfshirë edhe statusin e tyre të qëndrimit.

3. Sipas këtij ligji, viktimat dhe vartësit e tyre nuk mund të marrin kompensim të dyfishtë.

**Neni 5**  
**Dispozitat subsidiare**

Në çështjet procedurale që nuk mbulohen nga ky ligj aplikohen dispozitat e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

**KREU II**  
**E DREJTA PËR KOMPENSIMIN E VIKTIMAVE DHE LLOJET E KOMPENSIMEVE**

**Neni 6**  
**Veprat e dhunshme të kompensueshme**

1. Veprat e dhunshme të cilat hyjnë në kategorinë e veprave të kompensueshme sipas këtij Ligji janë:

1.1. vrasja;

1.2. trafikimi me njerëz;

1.3. dhunimi;

1.4. keqpërdorimi seksual i fëmijëve;

1.5. veprat penale që bien brenda përkufizimit të dhunës në familje sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.

2. Përveç veprave të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, Komisioni mund të shqyrtojë dhe vendosë për kërkesat e pranuar nga personat të cilët pretendojnë se janë viktimë të veprave tjera të dhunshme të cilat për shkak të natyrës së tyre dhe pasojës së shkaktuar mund të arsyetojnë kompensimin sipas këtij Ligji, në veçanti nëse viktimë është viktimë e ndjeshme.

3. Për të pasur të drejtë në kompensim viktimat e veprave të parapara me këtë nen duhet t'i plotësojnë kushtet formale dhe materiale.

**Neni 7**  
**Kushtet formale**

1. Kushtet formale për të drejtën në kompensim janë që parashtruesi i kërkesës:

1.1. të jetë shtetas ose banor i përhershëm i Republikës së Kosovës;

1.2. të jetë shtetas i cilitdo shtet, me të cilin Republika e Kosovës ka reciprocitet, apo;

1.3. të jetë shtetas i shtetit anëtar të BE-së.

## **Neni 8** **Kushtet materiale**

1. Kushtet materiale për të drejtën në kompensim në situatat vendore dhe situatat ndërkufitare vendore janë që vepra penale:

- 1.1. të jetë paraparë dënimi me minimum një vit burgim;
- 1.2. të jetë kryer në territorin e Republikës së Kosovës;
- 1.3. të jetë zbuluar dhe raportuar te autoriteti kompetent dhe të jetë trajtuar si vepër penale;
- 1.4. të mos jetë kryer nga pakujdesia;
- 1.5. të ketë rezultuar në vdekjen e viktimës, lëndim të rëndë trupor, dëmtim të rëndë të shëndetit fizik apo çrregullim të rëndë të shëndetit mendor;
- 1.6. të ketë rezultuar në dëmtim tjetër të përcaktuar me këtë Ligj, dhe;
- 1.7. viktimja e krimit të mos ketë mundësi të realizimit të kërkesës për kompensim nga sigurimi shëndetësor apo burime tjera.

2. Nëse vepra penale për të cilën kërkohet kompensim sipas këtij Ligjit rezulton në vdekjen e viktimës, vartësit e viktimës mund të gëzojnë të drejtat e parapara me këtë Ligj.

## **Neni 9** **Qasja e menjëhershme në kompensimin e viktimës**

1. Kërkesa për qasje të menjëhershme në kompensimin e viktimës mund të parashtrohet nëse personi me të drejtë në kompensim sipas këtij Ligji është fëmijë apo viktimë e huaj e trafikimit dhe kryesi i veprës mbetet i panjohur për tre (3) muaj nga zbulimi apo raportimi i veprës penale.

2. Viktimja e huaj e trafikimit duhet të bashkëpunojë arsyeshëm me organet e drejtësisë, për hetimin dhe ndjekjen e kryesit të veprës penale.

3. Në rast se brenda afatit për paraqitjen e kërkesës, viktimja e huaj e trafikimit gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, e njëjta mund t'ia paraqesë kërkesën direkt Komisionit sikurse edhe viktimat vendore.

## **Neni 10** **Obligimi për të kërkuar paraprakisht dëmshpërblim nga i pandehuri**

1. Para aplikimit për kompensim sipas këtij ligji, parashtruesi i kërkesës është i obliguar që, përveç rasteve të referuara në nenin 9 të këtij Ligji, të kërkojë fillimisht dëmshpërblim nga i pandehuri në pajtim me Kodin e Procedurës Penale.

2. Në rastet kur i pandehuri vetëm pjesërisht dëmshpërblen viktimën, atëherë viktimja ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për kompensim shtesë nga programi për kompensim të viktimave të krimit.

**Neni 11****Pamundësia e realizimit të dëmshpërblimit nga i pandehuri**

1. Parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të kërkojë kompensim sipas këtij Ligji, nëse dëmshpërblimi nuk mund të realizohet për shkak të rrethanave në vijim:

1.1. nëse personi ka qenë viktimë por dy (2) vjet kanë kaluar nga zbulimi i veprës penale dhe nuk ka pasur ngritje të aktakuzës;

1.2. nëse vërtetohet se personi ka qenë viktimë por i pandehuri në çështjen përkatëse penale lirohet, pasi ka qenë personi i gabuar, ndërkaq kryesi i veprës mbetet i panjohur;

1.3. nëse gjykata ka konstatuar se i pandehuri në çështjen përkatëse penale nuk është penalisht i përgjegjshëm;

1.4. nëse i pandehuri në çështjen përkatëse penale ka vdekur;

1.5. nëse përmbarimi në procedurë gjyqësore është bërë i pamundur apo kur nga shkaqë tjera të parapara me legjislacionin në fuqi i njëjti nuk mund të zbatohet.

**Neni 12****Llojet e kompensimeve**

1. Dëmtimet dhe shpenzimet në vijim mund të kompensohen sipas këtij ligji:

1.1. lëndimet të rënda fizike apo dëmtimi i shëndetit;

1.2. çrregullimet e rënda të shëndetit mendor;

1.3. humbja e aftësisë për punë dhe mbajtje;

1.4. shpenzimet mjekësore dhe të hospitalizimit;

1.5. shpenzimet e varrimit;

1.6. dëmet për pajisjet mjekësore të shkatërruara, dhe;

1.7. shpenzimet procedurale për parashtrimin e kërkesës për kompensim.

2. Dëmtimi i shkaktuar nga vepra penale duhet të jetë i natyrës së rëndë. Ajo i referohet si dëmtimit fizik ashtu edhe atij psikik.

3. Gjatë llogaritjes së kompensimit do të merren parasysh edhe lirimi nga tarifat mjekësore për kategoritë e caktuara të viktimave, siç përcaktohet me protokollet e miratuara nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

4. Qeveria e Republikës së Kosovës, nxjerr udhëzim administrativ për mënyrën e kompensimit,

përfshirë edhe llogaritjen e kompensimit për dëmtime të shumëfishta.

### **Neni 13**

#### **Kompensimi për lëndim fizik apo dëmtim të shëndetit**

1. Kompensimi do të jepet për lëndime të rënda fizike dhe dhembjet e pësuar nga to. Kompensimi nuk do të njihet për lëndime fizike për të cilat viktimat e krimit është paaftësuar përkohësisht apo për të cilat është paaftësuar në një shkallë më të ulët.

2. Lëndimet në vijim konsiderohen lëndime të rënda:

2.1. lëndimet që zgjasin më shumë se gjashtë (6) javë, të cilat rezultojnë në paaftësi të plotë për punë ose paaftësi për t'i kryer detyrat e përditshme;

2.2. lëndimet me pasoja të dukshme ose funksionale, afatgjate apo të përhershme;

2.3. lëndimet të cilat kanë qenë objektivisht kërcënuese për jetën.

3. Në bazë të këtij ligji, kompensimi për dhembje fizike, përcaktohet duke marrë parasysh rrethanat e rastit, shkalla e dhembjes së shkaktuar nga lëndimi apo dëmtimi i shëndetit, kohëzgjatja e dhembjes, dhe në përputhje me parimin e kompensimit të drejtë monetar, do të përcaktohet në pajtim me shkallët e mëposhtme:

3.1. rastet mesatarisht të rënda deri në një mijë e pesëqind (1,500) Euro;

3.2. rastet e rënda deri në tremijë (3,000) Euro;

3.3. rastet skajshmërisht të rënda deri në shtatë mijë (7,000) Euro.

### **Neni 14**

#### **Kompensimi për çrregullim të rëndë të shëndetit mendor**

1. Kompensimi për çrregullim të rëndë të shëndetit mendor, mund të paguhet vetëm kur shkak është një vepër e rëndë e dhunshme, me kusht që çrregullimi të konstatohet nga psikiatri apo psikologu.

2. Çrregullimi i rëndë i shëndetit mendor nuk përfshin gjendjen e paaftësisë apo çrregullimit të përkohshëm dhe gjendje të tilla të ngjashme. Pasoja duhet të jetë në atë shkallë që të ndikojë në aktivitetet e zakonshme të viktimës apo gjendjen psikologjike të tij për një periudhë të zgjatur kohore.

3. Kompensimi për çrregullim të rëndë të shëndetit mendor do të përcaktohet duke marrë parasysh rrethanat e rastit, llojin e dëmtimeve, nivelin dhe kohëzgjatjen e çrregullimit si dhe faktorë tjerë relevant.

4. Çrregullimi do të konsiderohet i rëndë për qëllime të këtij Ligji nëse është paraqitur si pasojë e:

4.1. kufizimit të lirisë;

4.2. abuzimit seksual;

4.3. shpërfytyrimin;

4.4. torturave të vazhdueshme;

4.5. lëndimeve tjera fizike të cilat mund të kenë ndikim në gjendjen, sjelljen dhe personalitetin e viktimës së atij krimi.

5. Kompensimi, i pranuar sipas paragrafit 4 të këtij neni, llogaritet në pajtim me çmimoren e shërbimeve mjekësore në institucionet e kujdesit shëndetësor publik lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe nuk mund të tejkalojë një shumë totale prej pesë mijë (5,000) Euro.

6. Kompensimi për vuajtje si pasojë e humbjes së anëtarit të familjes mund të njihet deri në shumën maksimale totale prej tremijë (3,000) Euro për të gjithë anëtarët e familjes së viktimës.

#### **Neni 15**

##### **Kompensimi për humbjen e aftësisë për punë apo të drejtës në mbajtje**

1. Parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë kompensim për humbjen e pagës për shkak të paaftësisë për punë, si pasojë e lëndimeve të shkaktuara nga vepra e dhunshme.

2. Vartësit kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesë për kompensim për humbjen e të drejtës në mbajtje në ato raste kur i ndjeri ka qenë mbajtësi i tyre kryesor.

3. E drejta në kompensim për humbje të aftësisë për punë do të njihet në një shumë të vetme, duke llogaritur jo më shumë se njëqind e pesëdhjetë (150) Euro në muaj, duke filluar nga paraqitja e dëmtimit sipas këtij neni dhe shumëzuar me numrin e muajve gjatë të cilave pritet që parashtruesi i kërkesës nuk do të jetë në gjendje të punojë.

4. Pa marrë parasysh paragrafin 3 të këtij neni, lartësia e kompensimit sipas këtij neni në asnjë rast nuk do të kalojë shumën maksimale prej tre mijë (3,000) Euro.

5. Kompensimi sipas këtij neni nuk e përjashton mundësinë që viktimës së krimit t'i njihet e drejta në kompensim në bazë të neneve tjera të këtij ligji.

#### **Neni 16**

##### **Kompensimi për shpenzimet mjekësore dhe të hospitalizimit**

1. E drejta në kompensim për shpenzime mjekësore dhe të hospitalizimit do të njihet dhe llogaritet në pajtim me çmimoren e shërbimeve mjekësore në institucionet e kujdesit shëndetësor publik, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë.

2. E drejta në kompensim sipas këtij neni në asnjë rast nuk do të kalojë shumën maksimale prej pesë mijë (5,000) Euro, përveç në rast të votës unanime të anëtarëve të Komisionit në të cilin rast kompensimi nuk do të kalojë shumën maksimale prej dhjetë mijë (10,000) Euro.

#### **Neni 17**

##### **Kompensimi i shpenzimeve të funeralit**

1. Shpenzimet e funeralit të viktimës do t'u kompensohen anëtarëve të familjes së të ndjerit të cilët kanë paguar për funeralin.
2. E drejta në kompensim sipas këtij neni në asnjë rast nuk do të kalojë shumën maksimale prej tre mijë (3,000) Euro.

#### **Neni 18**

##### **Dëmet për shkatërrimin e pajisjeve mjekësore**

1. Parashtruesi i kërkesës do të rimbursohet për pajisjet mjekësore të domosdoshme për shëndetin e viktimës dhe të cilat pajisje janë dëmtuar si pasojë e veprës së dhunshme nga i cili ka rezultuar edhe dëmtimi i viktimës.
2. Qasja në kompensim sipas këtij neni nuk do të kalojë shumën maksimale prej tremijë (3,000) Euro.

#### **Neni 19**

##### **Shpenzimet procedurale për parashtrimin e kërkesës për kompensim**

1. Parashtruesat në procedurat e kompensimit janë të përjashtuara nga çdo tarifë.
2. Komisioni do të vendosë për llojin e shërbimeve të rimbursueshme në mbështetje të kërkesës për kompensim.
3. Në vendimin për kompensim do të përfshihet edhe shuma për shpenzimet e rimbursueshme.

#### **Neni 20**

##### **Rrethanat që ndikojnë në kompensim**

1. Kompensimi mund të zvogëlohet ose të refuzohet:
  - 1.1. në varësi të kontributit të viktimës në shkaktimin e dëmit apo në përkeqësimin e dëmtimit të shkaktuar;
  - 1.2. në varësi të sjelljes së viktimës para, gjatë ose pas veprës penale;
  - 1.3. në varësi të përfshirjes së viktimës në krimin e organizuar apo të anëtarësisë së tij në një organizatë që përfshihet në krim të dhunshëm;
  - 1.4. nëse dhënia e plotë apo e pjesshme e kompensimit do të ishte në kundërshtim me kuptimin e drejtësisë apo rendit publik.



**Neni 21****Marrja parasysh e kompensimeve të tjera**

1. Shuma e kompensimit për një lloj të caktuar të dëmit sipas këtij ligji do të zvogëlohet për dëmet e mbuluara nga burimet tjera që përfituesi ka pranuar për të njëjtin lloj të dëmit për cilëndo bazë tjetër çfarëdo qoftë.
2. Në vendimin për kompensim Komisioni do të merr parasysh edhe cilindo dëmshpërblim të urdhëruar nga gjykata që vendos në çështjen penale për veprën për të cilin kërkohet kompensimi, përveç nëse ai dëmshpërblim nuk është paguar.

**Neni 22****Bartja e së drejtës në kompensim**

1. E drejta në paraqitjen e kërkesës për kompensim nuk bartet tek vartësit në rast të vdekjes së viktimës pas paraqitjes së kërkesës për kompensim.
2. Përgjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në rastet kur viktima e krimit ka kërkuar kompensim për lëndimet që iu janë shkaktuar si pasojë e veprave të dhunshme, por në ndërkohë i njëjti vdes jo si pasojë e atyre lëndimeve, anëtari i familjes së të ndjerit ka të drejtë në kompensim në rast të plotësimit kumulativ të kushteve të mëposhtme:

- 2.1. nëse Komisioni para vdekjes së viktimës ka marrë vendimin përfundimtar për kompensim të viktimës për lëndim, por ende nuk është bërë transferi i shumës së kompensimit në llogarinë e viktimës, dhe;
- 2.2. nëse anëtari i familjes ka qenë financiarisht i varur nga i ndjeri dhe nuk ka burime tjera të mbajtjes.

**KREU III****AUTORITET KOMPETENTE****Neni 23****Komisioni për kompensimin e viktimës së krimit**

1. Komisioni për kompensim të viktimave të krimit emërohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës me këtë përbërje:
  - 1.1. një (1) gjyqtar i Gjykatës Supreme, si kryetar i Komisionit, i propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
  - 1.2. një (1) prokuror i Prokurorisë së shtetit, i propozuar nga Këshilli Prokurorial;
  - 1.3. një (1) anëtar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i propozuar nga radhët e anëtarëve të Komisionit përkatës për legjislacion;
  - 1.4. një (1) përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, anëtar, i propozuar nga ministri i Drejtësisë;

1.5. dy (2) anëtarë ekspertë mjekësor të licencuar në fushën e traumatologjisë dhe psikiatrisë, të propozuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës;

1.6. një (1) përfaqësues nga shoqëria civile, anëtar me përvojë në fushën e të drejtave të njeriut apo ofrimit të shërbimeve për viktime, i propozuar nga organizatat e shoqërisë civile.

2. Mandati i anëtarëve të Komisionit është (3) tri vite. Përgjatimisht mandati i kryetarit të Komisionit është katër (4) vite.

3. Përbërja e Komisionit do të ketë parasysh kuotën gjinore dhe etnike.

#### **Neni 24**

##### **Pushimi dhe shkarkimi nga funksioni i anëtarit të Komisionit**

1. Anëtarëve të Komisionit u pushon funksioni i anëtarit me:

1.1. vdekje;

1.2. humbjen e zotësisë për veprim për më shumë se tre (3) muaj për shkak të arsyeve mjekësore të vërtetuara;

1.3. dështimin e vazhdueshëm për të marrë pjesë në veprimtaritë e Komisionit për më shumë se tre (3) muaj;

1.4. pushimin e statusit mbi të cilin bazohet caktimi si anëtar;

1.5. skadimin e mandatit;

1.6. dorëheqje duke informuar Komisionin me njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditësh.

2. Anëtarët e Komisionit shkarkohen nga funksioni para skadimit të mandatit për të cilin është zgjedhë nëse veprimet e tij e bëjnë të padenjë ushtrimin e funksionit të anëtarit të Komisionit dhe atë në raste kur anëtari:

2.1. kryen detyrat në Komision në mënyrë të pandërgjegjshme, dhe;

2.2. dënohet për vepër penale.

3. Nëse një vend në Komision lirohet para skadimit të mandatit të një anëtari, pozita e lirë plotësohet në të njëjtën mënyrë si për anëtarin të cilit i ka skaduar mandati.

#### **Neni 25**

##### **Kryerja e detyrave nga Komisioni**

1. Komisioni do të vendosë për kërkesat për kompensim në mbledhjet e thirrura nga Kryetari.

2. Sipas nevojës Komisioni mund të intervistojë apo kërkojë raport me shkrim nga zyrtarë përkatës, të cilët kanë qenë të përfshirë gjatë procedurës penale në rast dhe mund të kenë njohuri për ndikimin e veprës në viktimën.
3. Anëtarëve të Komisionit për punën e tyre u takon e drejta në shpërblim në pajtim me vendimin e Qeverisë.
4. Komisioni do të miratojë rregulloren e punës për mënyrën e funksionimit të tij.

## **Neni 26**

### **Përgjashtimi dhe kundërshtimi**

Dispozitat e Ligjit të procedurës kontestimore të cilat vlejnë për përgjashtimin e gjyqtarëve janë të aplikueshme në mënyrë analoge edhe për anëtarët e Komisionit për kompensim.

## **Neni 27**

### **Mbështetja administrative-teknike për Komisionin**

Ministria e Drejtësisë do të sigurojë mbështetjen administrative-teknike për Komisionin, përfshirë edhe përkthimin e dokumenteve.

## **Neni 28**

### **Obligimi për të siguruar informata**

1. Secili institucion i cili bie në kontakt me viktimën, ka për obligim të informojë atë për të drejtën në kompensim sipas këtij ligji. Institucionet shëndetësore, sociale, policia, prokuroria dhe gjykatat duhet t'i vendosin këto informata në dispozicion në vende publike.
2. Ministria e Drejtësisë do të publikojë në faqen e saj të internetit informatat e nevojshme për të kërkuar kompensim, formularët për paraqitje të kërkesës dhe udhëzimet tjera të nevojshme për të gjitha situatat vendore dhe ndërkufitare. Të gjitha informatat do të publikohen në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze.
3. Ministria e Drejtësisë në rast nevoje, do të ofrojë udhëzime të përgjithshme për parashtruesit e kërkesës. Udhëzimet do të përfshijnë informatat se si do të plotësohet aplikacioni dhe çfarë dokumentacioni mbështetës mund të jetë i nevojshëm.
4. Ministria e Drejtësisë, kurdo që është e nevojshme, do të sigurojë shkëmbimin e informatave me autoritetet kompetente të shteteve tjera, sipas rregulloreve të shteteve përkatëse kompetente për kryerje të detyrave në procedurat e kompensimit të kërkesave. Ministria e Drejtësisë do të ofrojë asistencë dhe të kërkojë zgjidhje adekuate lidhur me zbatimin e dispozitave në situatat ndërkufitare.
5. Me kërkesë të Komisionit, policia i siguron Komisionit informatën mbi veprën penale nga e cila pretendon se ka pësuar viktima.
6. Mbrojtësit e viktimave do të sigurohen që viktima të jetë e informuar me të drejtën e parashtrimit të kërkesës për kompensim.

## **KREU IV PROCEDURAT E KËRKIMIT TË KOMPENSIMIT**

### **Neni 29**

#### **Dorëzimi i kërkesës për kompensim**

1. Kërkesa për kompensim dorëzohet në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Për plotësimin e kërkesës për kompensim, viktimat e krimit mund të kërkojnë ndihmën e mbrojtësit të viktimave apo organizatave joqeveritare që ofrojnë ndihmë juridike falas për viktimat.
3. Në rast të angazhimit të avokatit privat për plotësimin dhe dorëzimin e kërkesës për kompensim, Komisioni nuk do të kompensojë parashtruesin e kërkesës për tarifën e kërkuar nga avokati privat.
4. Komisioni, në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, mund të shqyrtojë edhe kërkesat për kompensim të referuara nga Gjykata.

### **Neni 30**

#### **Përmbajtja e kërkesës për kompensim**

1. Kërkesa për kompensim do të përmbajë, por nuk do të kufizohet në të dhënat si në vijim:
  - 1.1. emrin dhe mbiemrin e viktimës së krimit, datën dhe vendin e lindjes, gjininë dhe profesionin kur është e aplikueshme, adresën e përhershme dhe të përkohshme, numrin e telefonit, punësimin, nacionalitetin dhe numrin personal. Në rast të një personi i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës, në vend të numrit personal shënohet ndonjë mënyrë tjetër e identifikimit në pajtim me rregulloret e shtetit përkatës;
  - 1.2. përshkrimi i veprës penale;
  - 1.3. përshkrimi i pasojave të veprës penale;
  - 1.4. përcaktimi se cili lloj i kompensimit kërkohet.
2. Në rast se kërkesa për kompensim parashtrohet nga ana e personave tjerë në emër të viktimës, atëherë ajo duhet të përmbajë edhe të dhënat e parashtruesit.
3. Viktima e krimit do të jep pëlqim për procesim të të dhënave personale përkatëse dhe të dhënat e ndjeshme personale për qëllim të vlerësimit të kërkesës për kompensim.
4. Nëse viktimat e krimit është e penguar për të dhënë pëlqim për shkak të dëmtimit fizik apo psikik, konsiderohet se të drejtën e dhënies së një pëlqimi të tillë e ka përfaqësuesi ligjor i viktimës.
5. Ministria e Drejtësisë do të përgatisë një format standard të kërkesës për kompensim.

6. Për situatat ndërkufitare vendore dhe të huaja kur viktimat është shtetas i ndonjë shteti tjetër do të hartohet një format i veçantë në pajtim me formularin në përdorim nga shtetet anëtare të BE-së.

7. Kërkesa duhet të dorëzohet në gjuhën shqipe apo serbe për viktimat vendore, ndërkaj për situatat ndërkufitare vendore është i pranueshëm edhe versioni në gjuhën angleze.

### **Neni 31**

#### **Afati për dorëzimin e kërkesës**

1. Kërkesa sipas nenit 9 të këtij Ligji do të dorëzohet më së voni brenda gjashtë (6) muajve nga data kur është zbuluar vepra e fundit penale nga e cila ka rrjedhur kërkesa për kompensim.

2. Kërkesat sipas paragrafit 2 të nenit 10 dhe paragrafët 1.2-1.5 të nenit 11 të këtij ligji, duhet të dorëzohet brenda gjashtë (6) muajve nga pranimi i vendimit të plotfuqishëm.

3. Për kërkesat sipas paragrafit 1.1 të nenit 11, afati prej gjashtë (6) muajve fillon të rrjedhë nga skadimi i afatit të dhënë sipas atij neni.

4. Përjashtimisht, nëse viktimat për shkak të dëmtimeve trupore, apo shkaqeve tjera të arsyeshme që pamundësojnë dorëzimin e kërkesës, nuk është në gjendje të dorëzojë kërkesën e tij deri në afatin e përcaktuar në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, ai do të dorëzojë kërkesën e tij më së voni brenda tre (3) muajsh nga dita kur arsyet për të cilat ai nuk ka qenë në gjendje të dorëzojë kërkesën kanë pushuar së ekzistuari.

5. Nëse viktimat është nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, afatet sipas paragrafit 4 të këtij neni do të fillojnë të rrjedhin pasi viktimat të mbushë moshën tetëmbëdhjetë 18 vjeçare.

### **Neni 32**

#### **Dokumentet që duhet bashkëngjitur kërkesës për kompensim**

1. Kërkesës së parashtruar në pajtim me nenin 9 të këtij Ligji i bashkëngjiten dokumentet në vijim:

1.1. dëshmia e shtetësisë ose e banimit të përhershëm;

1.2. çfarëdo dokumenti apo vërtetimi i policisë, i cili dokumenton se vepra penale është zbuluar, raportuar dhe trajtuar;

1.3. raportet përkatëse mjekësore dhe dokumentet që dëshmojnë që viktimat e krimit ka pësuar lëndim trupor, dëmtim të shëndetit apo vuajtje;

1.4. deklaratën e parashtruesit të kërkesës se nuk ka të drejtë të kërkojë kompensimin nga sigurimi shëndetësor. Vërtetësia e kësaj deklarate i nënshtrohet dispozitave përkatëse që i referohen deklaramit të rremë të Kodit Penal;

1.5. dokumentet tjera relevante në mbështetje të kërkesës për kompensim.

2. Në rast të një viktime të trafikimit, nëse parashtruesi i kërkesës nuk posedon dokumente identifikuese që sigurojnë dëshmi mbi shtetësinë, kushti nga paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i

këtij neni, konsiderohet i plotësuar kur raporti i policisë e identifikon parashtruesin e kërkesës si person i trafikuar, çfarë është shtetësia e tij dhe se ai nuk ka dokumente identifikuese.

3. Kërkesës së parashtruar në pajtim me nenin 10 dhe 11 të këtij ligji varësisht nga specifikat e rastit, përveç dokumenteve të kërkuara sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet t'i bashkëngjiten edhe:

3.1. vendimi i plotfuqishëm;

3.2. vendimi për ekzekutim, respektivisht dëshmi se ekzekutimi nuk ishte i suksesshëm apo dëshmi se përmbarimi nuk ka qenë i mundur.

4. Dokumentet e hartuara në ndonjë gjuhë të huaj, përveç gjuhës angleze, do të shoqërohet me një përkthim të certifikuar në gjuhën shqipe, serbe apo angleze.

5. Të gjitha kërkesat dhe dokumentet që transmetohen gjatë komunikimit në mes të autoriteteve në situata ndërkuftare, duhet të përjashtohen nga çdo lloj i verifikimit autentik apo formaliteti ekuivalent.

### **Neni 33**

#### **Shqyrtimi paraprak i kërkesës**

1. Komisioni do të refuzojë kërkesat të cilat nuk janë dorëzuar në afatin e përcaktuar me ligj.

2. Komisioni gjithashtu do të refuzojë kërkesat të cilat janë të pakompletuara dhe të pakuptueshme, përveç nëse parashtruesi i kërkesës i korrigjon mangësitë deri në afatin e përcaktuar.

3. Afati i përcaktuar nga Komisioni për korrigjimin e një mangësie në një kërkesë të pakompletuar dhe të pakuptueshme nuk duhet të jetë më i shkurtër se tridhjetë (30) ditë.

### **Neni 34**

#### **Marrja e vendimeve lidhur me kërkesën**

1. Vendimet e Komisionit merren me shumicë votash.

2. Komisioni do të:

2.1. pranojë kërkesën në tërësi apo pjesërisht, dhe të caktojë lartësinë e kompensimit, apo;

2.2. refuzojë kërkesën si të pabazuar.

3. Komisioni mund të mbajë mbledhje kur janë prezent 2/3 e anëtarëve.

4. Komisioni merr vendim brenda nëntëdhjetë (90) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës së plotë.

5. Një kopje e vendimit do t'i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe gjykatës kompetente.

6. Nëse viktimi e krimit është fëmijë, apo person pa aftësi të veprimit, një kopje e vendimit do t'i dërgohet kujdestarit ligjor.

7. Pala e pakënaqur ndaj vendimit të Komisionit mund të iniciojë konflikt administrativ në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

8. Vendimi për njohjen e të drejtës në kompensim do të përmbajë edhe klauzolën për transferimin e kërkesës sipas nenit 43 të këtij ligji, ndaj kryesit, nga përfituesi në buxhetin e Republikës së Kosovës deri në lartësinë e kompensimit të dhënë.

### **Neni 35**

#### **Transmetimi dhe qasja në të dhëna**

1. Administratorët e bazave të të dhënave të informacionit personal, autoritetet shtetërore, autoritetet e komuniteteve lokale dhe organet që ushtrojnë kompetenca publike të cilat posedojnë të dhëna mbi rrethanat dhe faktet e rëndësishme për vendimmarrje, duhet të transferojnë të dhënat e lartpërmendura te Komisioni çdoherë kur kjo kërkohet me shkrim.

2. Pas një kërkesë me shkrim nga Komisioni, të dhënat mbi rrethanat dhe faktet e rëndësishme për vendimmarrje gjithashtu mund t'i dorëzohen vullnetarisht Komisionit nga individët në posedim të të dhënave.

3. Qasja në përmbajtjen e aktakuzës, dokumentet përcjellëse, raportet e Prokurorisë së Shtetit, dhe vendimet e gjykatës, të cilat i posedon Komisioni për qëllime të vendimmarrjes, mund t'u vihen në dispozicion vetëm anëtarëve të Komisionit, viktimës apo përfaqësuesit të tij ligjor, përfaqësuesit të autorizuar dhe autoriteteve kompetente shtetërore.

## **KREU V**

### **PROCEDURAT NË SITUATAT NDËRKUFITARE**

#### **Neni 36**

##### **Situatat ndërkufitare**

1. Situatat ndërkufitare përfshijnë situatat ndërkufitare vendore dhe të huaja.

2. Situata ndërkufitare vendore është situata kur vepra është kryer në territorin e Republikës së Kosovës. Në këtë rast Komisioni i themeluar sipas këtij Ligji është në rolin e autoritetit vendimmarrës ndërkaq kërkesa për kompensim nga ana e viktimës së huaj dorëzohet përmes autoritetit asistues të shtetit të huaj, shtetas i së cilës është viktima e huaj.

3. Situata ndërkufitare e huaj është situata kur vepra është kryer në një shtet tjetër ku e drejta në kompensim përcaktohet me vendim të autoritetit vendimmarrës të atij shteti. Parashtruesi i kërkesës në këtë rast është shtetasi i Republikës së Kosovës, ndërkaq Ministria e Drejtësisë është në rolin e autoritetit asistues dhe është përgjegjëse për transmetimin e kërkesave të parashtruesit të kërkesës autoritetit të huaj vendimmarrës.

#### **Neni 37**

##### **Situatat ndërkufitare vendore**

1. Me të pranuar kërkesën nga autoriteti kompetent i një shteti të huaj, shtetas i së cilës është një viktimë e krimit, Ministria e Drejtësisë do t'i komunikojë autoritetit përkatës të shtetit të huaj, brenda tridhjetë (30) ditëve informatat në vijim :

- 1.1. konfirmimin për marrjen e kërkesës;
  - 1.2. të dhënat e personit kontaktues, apo departamentit përgjegjës për çështjen, dhe;
  - 1.3. nëse është e mundur, një afat të përafërt kur do të merret një vendim mbi kërkesën.
2. Nëse kërkesa e pranuar nuk është dërguar në formularin standard të përcaktuar nga Ministria e Drejtësisë apo kërkesa nuk është e kompletuar, e njëjta do t'i kthehet për plotësim autoritetit nga e ka pranuar atë.
3. Nëse kërkesa dhe dokumentet e bashkëngjitura nuk janë në gjuhën shqipe, serbe apo angleze, Ministria e Drejtësisë do t'ia kthejë ato parashtruesit të kërkesës ose autoritetit nga i ka pranuar ato, të shoqëruara nga një udhëzim për përdorimin e gjuhës shqipe, serbe apo angleze në përputhje me nenet 30 dhe 32 të këtij Ligji.
4. Ministria e Drejtësisë, sa më parë që është e mundur, do t'i përcjellë Komisionit kërkesën e pranuar për kompensim së bashku me të gjitha dokumentet përcjellëse.
5. Nëse Komisioni zbulon në një situatë ndërkufitare vendore që vendimi për këtë çështje përkatëse kërkon procedura të veçanta, sikur dëgjimin e viktimës së krimit, dëshmitarit ose ekspertit, mund të kërkojë nga autoriteti i huaj asistues në të cilën viktimë e krimit ka paraqit kërkesën e tij për kompensim, për të kryer procedurat përkatëse, me kusht që personi që dëgjohet të pajtohet për seancën dëgjimore apo intervistën e tillë.
6. Seanca dëgjimore e kërkuar në procedurën përkatëse gjithashtu mund të kryhet edhe nëpërmjet video-konferencës apo tele-komunikimit, me kusht që personi që dëgjohet të pajtohet.
7. Seancat e referuara në paragrafin e mësipërm do të kryhet nga Kryetari i Komisionit ose nga anëtarë të Komisionit, i autorizuar në përputhje me rrethanat nga Kryetari i Komisionit.
8. Vendimi i Komisionit do t'i dërgohet nga Ministria e Drejtësisë parashtruesit të kërkesës dhe autoritetit asistues të shtetit të huaj, në një formular standard të përcaktuar nga Ministria e Drejtësisë.

### **Neni 38**

#### **Situatat ndërkufitare të huaja**

1. Në rast të situatës ndërkufitare të huaj parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë kërkesën e tij për dëshmipërblim në Ministrinë e Drejtësisë duke përdorur formularin standard të përcaktuar me nenin 30, paragrafin 6 të këtij ligji.
2. Sa më parë që është e mundur, Ministria e Drejtësisë do të dërgojë kërkesën bashkë me dokumentet përcjellëse autoritetit kompetent të shtetit prej ku parashtruesi i kërkesës kërkon kompensimin. Nëse autoriteti i huaj vendimmarrës nuk do të pranojë kërkesën, apo do të kërkojë të dhëna shtesë, Ministria e Drejtësisë do të informojë menjëherë parashtruesin e kërkesës.
3. Ministria e Drejtësisë do të sigurohet që kërkesa zyrtare për kompensim e dërguar tek autoriteti i huaj vendimmarrës do të bëhet në formularin e caktuar nga autoriteti i atij shteti.
4. Kërkesa bashkë me dokumentet përcjellëse do të dërgohen në një nga gjuhët zyrtare të



shtetit të cilit i dërgohet kërkesa apo në një nga gjuhët zyrtare të BE të cilat shteti pranues ka deklaruar se mund t'i pranojë.

5. Nëse një autoritet i huaj vendimmarrës kërkon që një seancë dëgjimore apo intervistë e viktimës së krimit, dëshmitarit ose ekspertit të mbahet në Republikën e Kosovës, seanca dëgjimore apo intervista e tillë do të kryhet nga Komisioni, me kusht që personi që dëgjohej të pajtohet për seancën dëgjimore apo intervistën e tillë. Komisioni do t'i dërgojë një raport për seancën dëgjimore autoritetit të huaj vendimmarrës.

6. Nëse një autoritet i huaj vendimmarrës kërkon që seanca dëgjimore të kryhet përmes përdorimit të video-konferencës apo telekomunikimit, dëgjimi i tillë do të kryhet në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, me kusht që personi i cili do të dëgjohej pajtohet për dëgjim të tillë.

7. Ministria e Drejtësisë në rolin e autoritetit asistues, nuk duhet të bëjë vlerësimin e kërkesës së parashtruar për kompensim.

8. Veprimet e kryera nga Ministria e Drejtësisë në rolin e autoritetit asistues, nuk mund të ankimohen dhe nuk mund të paraqesin bazë për kërkesë për kompensim të tarifave apo shpenzimeve nga parashtruesi i kërkesës apo autoriteti vendimmarrës i shtetit të huaj.

## **KREU VI PROGRAMIT PËR KOMPENSIMIN E VIKTIMAVE TË KRIMIT**

### **Neni 39 Financimi i Kompensimit të Viktimave të Krimit**

1. Programi për kompensimin e viktimave të krimit do të financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës për Ministrinë e Drejtësisë si pjesë e ligjit vjetor të buxhetit.

2. Programi për kompensimin e viktimave mund të financohet edhe përmes kontributeve vullnetare dhe donacioneve private në pajtim me Rregullat e Kontrollit dhe Menaxhimit Financiar.

3. Gjyqtarët me rastin e shqiptimit të sanksioneve penale për veprat penale të përcaktuara në nënparagrafët 3.1 dhe 3.2 të këtij paragrafi, edhe taksat për kompensimin e viktimave si në vijim:

3.1. për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore shuma prej tridhjetë (30) Euro;

3.2. për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Krimeve të Rënda i Gjykatës Themelore shuma prej pesëdhjetë (50) Euro.

4. Gjatë procesit të rregullt buxhetor të përcaktuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ministria e Drejtësisë do të bëjë një kërkesë buxhetore për të financuar një linjë buxhetore për programin e kompensimit të viktimave të krimit. Kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë do të ketë parasysh projeksionet për të hyrat e pritura nga paragrafi 3 i këtij neni.

5. Niveli i ndarjeve buxhetore për programin e kompensimit të viktimave të krimit do të bëhet përmes proceseve të rregullta buxhetore, duke marrë parasysh të hyrat e pritura nga paragrafi

3 i këtij Neni, të hyrat nga shitja e pasurisë së paligjshme të konfiskuar, të hyrat nga dorëzania e konfiskuar në pajtim me ligjin si dhe nivelin e përgjithshëm të të hyrave të pritura buxhetore dhe kërkesave për financim nga Buxheti i Kosovës.

6. Ndarjet e para buxhetore për Programin për kompensimin e viktimave të krimit, do të bëhen përmes procesit të parë buxhetor pasues pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

#### **Neni 40**

#### **Raportimi Financiar**

1. Si pjesë e kërkesës buxhetore sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ministria e Drejtësisë do t'i dorëzojë Ministrisë së Financave një raport vjetor mbi:

- 1.1. numrin e përgjithshëm të parashtruesve të kërkesave;
- 1.2. numrin e parashtruesve të kërkesave që u është mohuar kompensimi;
- 1.3. numrin i parashtruesve të kërkesave që u është dhënë kompensimi;
- 1.4. shumën e kompensimit, të dhënë parashtruesve të kërkesave, dhe;
- 1.5. shpenzimet e Komisionit.

#### **KREU VII**

#### **REGJISTRAT PËR PARASHTRUESIT E KËRKESAVE DHE PËR VENDIMET E LËSHUARA**

#### **Neni 41**

#### **Mbajtja e regjistrave**

1. Ministria e Drejtësisë do të mbajë regjistrat për parashtruesit e kërkesës dhe për vendimet e lëshuara rreth kompensimeve. Përmbajtja e këtyre regjistrave rregullohet me udhëzim administrativ nga Qeveria e Republikës së Kosovës .

2. Regjistrat do të mbahen në raste individuale, secili i shënuar me numrin e saj vijues dhe numrin e lëndës.

3. Numri i lëndës është numri që i atribuohet rastit me dorëzimin e kërkesës në Ministrinë e Drejtësisë.

#### **Neni 42**

#### **Ruajtja e informatave**

1. Të gjitha dosjet e parashtruesve të kërkesave për kompensim do të ruhen në pajtim me afatet e parapara në legjislacionin përkatës në fuqi.

2. Kërkesat për kompensim, dëshmitë, ekspertizat dhe regjistrat janë të dhëna personale të ndjeshme e të cilat duhet të përpunohen dhe ruhen me konfidencialitet, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

## **KREU VIII**

### **TRANSFERIMI I KËRKESAVE DHE KTHIMI I MJETEVE TË MARRA NË MËNYRË JO TË DREJTË**

#### **Neni 43**

##### **Transferimi i kërkesave**

1. Kërkesat e përfituesit ndaj kryesit do të kalojnë, deri në lartësinë e kompensimit në Qeverinë e Kosovës në ditën e ekzekutimit të vendimit për njohjen e të drejtës për kompensim.
2. Me transferimin e kërkesës sipas paragrafit 1 të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës në raport me kryesin do të veprojë në cilësinë e përfituesit.
3. Për çdo pretendim që rrjedh nga ky nen, Ministria e Drejtësisë do të ndërmerr veprimet e nevojshme zyrtare për realizimin e dëmshpërblimit, respektivisht kompensimit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 44**

##### **Kthimi i mjeteve të marra në mënyrë jo të drejtë**

1. Në rast të pranimit të informatës se kompensimi i përfituesit është bërë mbi bazën e të dhënave të rreme/falsifikuara apo çfarëdo mashtrimi të mundshëm me qëllim të realizimit të kërkesës për kompensim, Komisioni dhe çdo palë tjetër e interesuar duhet të informojë prokurorin e shtetit.
2. Përfituesi i kompensimit sipas këtij Ligji, ka për obligim të informojë Komisionin në çdo kohë nëse pas marrjes së kompensimit apo deri në ekzekutimin e vendimit të Komisionit, përfituesi përfiton dëmshpërblim nga burimet tjera.

## **KREU IX**

### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 45**

##### **Dispozitat kalimtare**

1. Të drejtë në qasje për kompensim sipas këtij Ligji do të kenë gjithashtu të gjithë shtetasit e vendeve të tjera, detyrimin për kompensimin e të cilëve Republika e Kosovës e ndërmerr me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare.
2. Procedurat në situatat ndërkufitare në raport me shtetet e BE-së, të përcaktuara me këtë Ligj, do të fillojnë të zbatohen nga dita e marrjes së detyrimeve kontraktuale apo nga dita e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian.

#### **Neni 46**

##### **Aktet Nënligjore**

Qeveria e Republikës së Kosovës, brenda gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji nxjerr aktet nënligjore të parapara në këtë ligj.

**Neni 47**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa nenet 6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17,18,19,20,21,22, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 40, 41, 42, 43 dhe 44 fillojnë të zbatohen një (1) vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Ligji Nr. 05/L -036**  
**28 maj 2015**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-009-2015, datë 15.06.2015 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.**